

**STATUT I SHOQËRISË ME
PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
XPONENTL DATA ALBANIA SHPK**

Date: 31.3.2025



**STATUTE OF THE LIMITED
LIABILITY COMPANY XPONENTL
DATA ALBANIA SHPK**

Date: 31.3.2025




TABELA E PËRMBAJTJES

KREU I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1.1 Përkufizimet

KREU II. ORGANIZIMI

Neni 2.1 Themelimi dhe Organizimi

Neni 2.2 Struktura e Shoqërisë

Neni 2.3 Emërtimi

Neni 2.4 Objekti

Neni 2.5 Vendi i Ushtrimit të Veprimtarisë

Neni 2.6 Afati

KREU III. ORTAKËT

Neni 3.1 Ortakët

Neni 3.2 Kompetencat e Ortakut të Vetëm

Neni 3.3 Vendim marrja

KREU IV. ADMINISTRATORI

Neni 4.1 Emërimi

Neni 4.2 Shkarkimi dhe Dorëheqja

Neni 4.3 Kompetencat e Administratorit

KREU V. KAPITALI

Neni 5.1 Kapitali i Regjistruar

Neni 5.2 Regjistri i Kuotave

Neni 5.3 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

Neni 5.4 Dividendi

KREU VI. BUXHETI

Neni 6.1 Buxheti

Neni 6.2 Librat e Shoqërisë dhe Përputhshmëria

KREU VII. TË NDRYSHME

Neni 7.1 Veçueshmëria

Neni 7.2 Legjislacioni i Zbatueshëm

Neni 7.3 Prishja dhe Likuidimi

Shtojca 1 – Specimen i Nënshkrimit të Administratorit

TABLE OF CONTENTS

CHAPTER 1. GENERAL CLAUSES

Article 1.1 Definitions

CHAPTER II. ORGANIZATION

Article 2.1 Establishment and Organization

Article 2.2 Structure of the Company

Article 2.3 Name

Article 2.4 Scope

Article 2.5 Registered Office

Article 2.6 Term

CHAPTER III. MEMBERS

Article 3.1 Members

Article 3.2 Powers of Sole Member

Article 3.3 Decision-making

CHAPTER IV. ADMINISTRATOR

Article 4.1 Appointment

Article 4.2 Dismissal and Resignation

Article 4.3 Powers of the Administrator

CHAPTER V. CAPITAL

Article 5.1 Registered Capital

Article 5.2 Register of Shares

Article 5.3 Increase and Reduction of the Capital

Article 5.4 Dividend

CHAPTER VI. BUDGET

Article 6.1 Budget

Article 6.2 Books of the Company and Compliance

CHAPTER VII. MISCELLANEOUS

Article 7.1 Severability

Article 7.2 Applicable Law

Article 7.3 Dissolution and Liquidation

Annex 1 – Signature Specimen of the Administrator

KREU I. TË PËRGJITHSHME

Neni 1.1 Përkufizimet

Fjalët e përdorura në këtë Statut me germa kapitale do të kenë kuptimin si më poshtë:

“**Data e Nënshkrimit**” është data në të cilën është nënshkruar ky Statut.

“**Legjislacion i Zbatueshëm**” do të thotë çdo ligj, akt nënligjor, akt normativ kombëtar apo lokal, urdhër, dekret apo akt tjetër, kod, direktivë, vendime dhe akte të ministrave, qarkore të departamenteve, rregullore, deklarata dhe interpretime të organeve zyrtare të Republikës së Shqipërisë, çdo vendim gjyqësor apo çdo licencë, aprovim, leje apo autorizim apo miratime të tjera në fuqi, të Republikës së Shqipërisë, apo të çdo njësie apo ndarje administrative ose të çdo Personi të krijuar me ligj, (qoftë i pavaruar apo jo), që ka juridiksionin përkatës, përfshirë ndryshimet e herëpashershme të tyre.

“**Ligji për Shoqëritë Tregtare**” është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i ndryshuar.

“**Ortaku i Vetëm**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 3.1 (*Ortakët*).

“**QKB**” është Qendra Kombëtare e Biznesit në Shqipëri.

“**Statuti**” është statuti i Shoqërisë.

“**Shoqëria**” ka kuptimin që i është dhënë te Neni 2.3 (*Emërtimi*) i këtij Statuti.

“**Vit Fiskal**” është çdo vit financiar që fillon më datën 1 Janar dhe mbyllet më datën 31 Dhjetor.

CHAPTER I. GENERAL CLAUSES

Article 1.1 Definitions

The capitalized terms used in this Statute will have the following meaning:

“**Applicable Law**” means any law, bylaw, national or local normative act, order, decree or other act, code, directive, decisions and acts of ministers, circulars of departments, regulations, statements and interpretations of official bodies of the Republic of Albania, any court decision or any license, approval, permit or authorization or other approvals in force, of the Republic of Albania, or of any administrative unit or division or of any Person created by law, (whether independent or not), having the relevant jurisdiction, including their occasional changes.

“**Company**” has the meaning given in Article 2.3 (*Name*).

“**Fiscal Year**” is the financial year that starts on January 1 and ends on December 31.

“**Law on Companies**” means Law No. 9901, dt. 14.04.2008 “*On Entrepreneurs and Companies*”, as amended.

“**NBC**” means the National Business Center in Albania

“**Signing Date**” means the date when this Statute is signed.

“**Sole Member**” has the meaning given in Article 3.1 (*Members*).

“**Statute**” means the statute of the Company.

KREU II. ORGANIZIMI I SHOQËRISË

Neni 2.1 Themelimi dhe Organizimi

Ortaku i Vetëm miraton themelimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar, në përputhje me Ligjin për Shoqëritë Tregtare, për qëllimet dhe brenda fushës së zbatimit të përcaktuar nga ky Statut. Ortaku i Vetëm do të paraqesë menjëherë dokumentet e nevojshme në QKB, në lidhje me formimin dhe funksionimin e Shoqërisë, siç mund të kërkohet ose është e përshtatshme sipas Legjislacionit të Zbatueshëm.

Neni 2.2 Struktura e Shoqërisë

Shoqëria do të organizohet në përputhje me parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare. Organet e shoqërisë do të jenë Ortaku i Vetëm dhe Administratori.

Neni 2.3 Emërtimi

Emri i shoqërisë do të jetë XponentL Data Albania shpk ("Shoqëria"). Shoqëria mund të ushtrojë aktivitetin, nën çdo emër tjetër të miratuar nga Ortaku i Vetëm.

Neni 2.4 Objekti

Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë do të përfshijë aktivitetet e mëposhtme:

1. Projektimi i Përvojave të Përdoruesve (UX) dhe Platformave Tregtare Online

- Krijimi dhe përmirësimi i platformave tregtare online.
- Zhvillimi i dizajneve fillestare (wireframes) dhe përshkrimeve të përdoruesve idealë (persona).
- Ndërtimi dhe zhvillimi i tregjeve online funksionale.
- Hartimi i strategjive për të mbështetur dhe fuqizuar përdoruesit në platforma.

2. Menaxhimi Inteligjent i të Dhënave

- Sigurimi i cilësisë së të dhënave përmes zgjidhjeve të specializuara teknologjike.

CHAPTER II. ORGANIZATION OF THE COMPANY

Article 2.1 Establishment and Organization

The Sole Member approves the establishment of a limited liability company, in accordance with the Law on Companies, for the purposes and within the scope of application determined by this Statute. The Sole Member shall promptly file with the NBC the necessary documents relating to the formation and operation of the Company, as may be required or appropriate under the Applicable Law.

Article 2.2 Structure of the Company

The Company will be organized in accordance with the provisions of the Law on Companies. The bodies of the Company will be the Sole Member and the Administrator.

Article 2.3 Name

The name of the Company will be XponentL Data Albania shpk (the "**Company**"). The Company may exercise its activity under any other name determined by the Sole Member.

Article 2.4 Scope

The scope of the Company's activities will include the following operations:

1. User Experience (UX) and Marketplace Design

- Designing and optimizing online marketplaces.
- Developing wireframes and user personas.
- Building and implementing marketplaces.
- Creating enablement strategies to support user engagement.

2. Intelligent Data Management

- Improving data quality through engineering solutions.

- Menaxhimi i metadata-s dhe gjurmimi i origjinës së të dhënave.
- Zhvillimi i sistemeve inteligjente për organizimin dhe administrimin e të dhënave kryesore.

3. Zhvillimi dhe Mbështetja e Platformave Moderne të të Dhënave

- Zhvillimi i inxhinierive dhe përpunimit të dhënash.
- Inxhinieri njohurish për sisteme të avancuara të të dhënave.
- Zhvillimi i zgjidhjeve inxhinierike për kërkim, zbulim dhe indeksim të të dhënave.
- Zhvillimi i teknologjive për Përpunimin e Gjuhës Natyrore (NLP) dhe Modelet e Mëdha të Gjuhës (LLM).
- Modelimi i marrëdhënieve grafike dhe strukturave të lidhura.
- Zhvillimi i zgjidhjeve inxhinierike për Inteligjencën Artificiale gjeneruese dhe Modelet e Mëdha të Gjuhës.

4. Shërbime Konsulente në Fushën e IT-së

- Kryerja e auditimeve të sistemeve dhe rekomandimi i përmirësimeve.
- Zhvillimi i strategjive teknologjike për rritjen e biznesit.
- Ofrimi i konsulencës për iniciativat e transformimit digjital.
- Planifikimi dhe optimizimi i infrastrukturës IT.
- Projektimi dhe menaxhimi i bazave të të dhënave.
- Ofrimi i zgjidhjeve për analizën dhe vizualizimin e të dhënave.
- Menaxhimi i cilësisë dhe integritetit të të dhënave për analiza të avancuara.
- Përpunimi i të dhënave për aplikacione të Inteligjencës Artificiale dhe Big Data.
- Krijimi i chatbot-eve dhe sistemeve të shërbimeve të automatizuara.

- Managing metadata and ensuring data lineage.
- Implementing intelligent master data management systems.

3. Development and Support of Modern Data Platforms

- Data engineering and processing.
- Knowledge engineering for advanced data systems.
- Engineering for search, discovery, and data indexing.
- Natural Language Processing (NLP) and Large Language Model (LLM) development.
- Graph relationships and domain modeling.
- Engineering solutions for generative AI and large language models.

4. IT Consulting Services

- Conducting system audits and recommending improvements.
- Developing technological strategies for business growth.
- Consulting for digital transformation initiatives.
- Planning and optimizing IT infrastructure.
- Designing and managing databases.
- Providing data analysis and visualization solutions.
- Managing data quality and integration for advanced analytics.
- Processing data for AI and Big Data applications.
- Creating chatbots and automated service systems.

5. Veprimtari të Përgjithshme • Çdo veprimtari tjetër e lejuar nga legjislacioni shqiptar.	5. General Activities • Any other activity permitted by Albanian legislation.
Neni 2.5 Vendi i ushtrimit të veprimtarisë a. <u>Selia</u>. Selia e Shoqërisë do të jetë e vendosur në: Rruga Shyqyri Brari, Pallati Aurora, Shkalla 6, Apartamenti 26, Tiranë, Shqipëri. b. <u>Email</u>. Adresa e Shoqërisë për qëllime të komunikimit elektronik do të jetë frank.rotonta@xponentl.ai	Article 2.5 Registered Office a. <u>Headquarters</u>. The registered office of the Company will be located at: Shyqyri Brari Street, Aurora Building, Staircase 6, Apartment 26, Tirana, Albania. b. <u>Email</u>. The Company's address for electronic communication purposes will be frank.rotonta@xponentl.ai
Neni 2.6 Afati a. <u>Fillimi</u>. Shoqëria do të fillojë veprimtarinë në datën e regjistrimit të saj në regjistrin tregtar të QKB, me kusht që të plotësohen kërkesat e themelimit të përcaktuara në Nenin 2.1 (<i>Themelimi dhe Organizimi</i>) këtu. b. <u>Kohëzgjatja</u>. Kohëzgjatja e Shoqërisë do të vazhdojë për një kohë të pacaktuar, ose deri në prishjen e Shoqërisë në përputhje me dispozitat e këtij Statuti, vendimeve të marra në bazë të tij, ose kur parashikohet nga Legjislacioni i Zbatueshëm.	Article 2.6 Deadline a. <u>Date of Registration</u>. The Company will start operating on the date of its registration in commercial registry of the NBC, provided that the establishment requirements set forth in Article 2.1 herein (<i>Establishment and Organization</i>) are met. b. <u>Duration</u>. The Company will exercise its activities indefinitely, or until the dissolution of the Company in accordance with the provisions of this Statute, the decisions based on it, or when provided by the Applicable Law.
KREU III. ORTAKËT Neni 3.1 Ortakët Ortaku i vetëm themelues i Shoqërisë është XponentL Data, Inc., një korporatë amerikane, e themeluar dhe regjistruar sipas ligjeve të Shtetit të Delaware, SHBA, me numër identifikimi (FEIN) 92-2329043, me adresë në Corporation Trust Center 1209 Orange St., Wilmington, Delaware, SHBA ("Ortaku i Vetëm"). Ortaku i Vetëm do të jetë autoriteti më i lartë i Shoqërisë.	CHAPTER III. MEMBERS Article 3.1 Members The sole founding member of the Company is XponentL Data, Inc., a U.S. corporation, duly incorporated and registered in the State of Delaware, with identification number (FEIN) 92-2329043, with its registered office at Corporation Trust Center 1209 Orange St., Wilmington, Delaware ("Sole Member"). The Sole Member will be the highest authority of the Company.

Neni 3.2 Kompetencat e Ortakut të Vetëm

- a. Kompetencat Kryesore. Ortaku i Vetëm ka këto kompetenca:
- Ndryshimet në dispozitat e Statutit;
 - Caktimi dhe shkarkimi i administratorit;
 - Caktimi dhe shkarkimi i ekspertit/ekspertëve kontabël si dhe likuidatorit/likuidatorëve;
 - Miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - Shpërndarja e dividendëve;
 - Ndryshimi i kapitalit të regjistruar; dhe
 - Likuidimi dhe/ose shndërrimi i shoqërisë në një formë tjetër.
- b. Kompetenca të tjera. Ortaku i Vetëm veç sa parashikohet në pikën a të këtij Neni, ushtron çdo kompetencë tjetër të parashikuar nga Ligji për Shoqëritë Tregtare apo ky Statut.

Article 3.2 Powers of the Sole Member

- a. Main Powers. The Sole Member has the following powers:
- Changes in the provisions of the Statute;
 - Appointment and dismissal of the administrator;
 - Appointment and dismissal of the accounting expert/experts as well as the liquidator/liquidators;
 - Approval of the annual statement of accounts and performance reports;
 - Distribution of dividends;
 - Change of the registered capital; and
 - Liquidation and/or transformation of the company into another form.
- b. Other powers. The Sole Member, apart from what is provided in point a of this Article, exercises any other powers provided by the Law on Companies or this Statute.

Neni 3.3 Vendimmarrja

Ortaku i Vetëm do të realizojë të gjithë të drejtat dhe do të përmbushë të gjithë detyrimet që rrjedhin nga Ligji për Shoqëritë Tregtare. Ortaku i Vetëm do të marrë vendimet e duhura për Shoqërinë dhe do të mandatojë Administratorin e saj ose këdo person tjetër, sipas rastit, që të nënshkruajë dhe ekzekutojë vendimet e Ortakut të Vetëm.

Article 3.3 Decision-making

The Sole Member will exercise all rights and fulfill all obligations arising from the Law on Companies. The Sole Member shall take the appropriate decisions for the Company and mandate its Administrator or any other person, as the case may be, to sign and execute the decisions of the Sole Member.

KREU IV. ADMINISTRATORI

Neni 4.1 Emërimi

- a. Administratori. Administratori i Shoqërisë është znj. Elkida Bazaj, shtetase shqiptare, mbajtëse e letërnjoftimit ID me numër J76113002U.

CHAPTER IV. ADMINISTRATOR

Article 4.1 Appointment

- a. Administrator. The Administrator of the Company is Ms. Elkida Bazaj, Albanian citizen, holder of the ID with no. J76113002U.

- b. Mandati. Administratori emërohet për një periudhë kohore prej 3 (tre) vitesh, me të drejtë rizgjedhjeje.

- b. Mandate. The Administrator is appointed for a period of 3 (three) years, with the right to be reelected.

Neni 4.2 Shkarkimi dhe Dorëheqja

- a. Shkarkimi. Adminsitratori mund të shkarkohet nga Ortaku i Vetëm në çdo kohë, me ose pa shkak, sa herë që sipas gjykimit të Ortakut të Vetëm do të përmbushen interesat më të mira të Shoqërisë.
- b. Dorëheqja. Administratori mund të japë dorëheqjen duke njoftuar me shkrim Ortakun e Vetëm. Përveç nëse specifikohet ndryshe në këtë njoftim, dorëheqja do të hyjë në fuqi me marrjen e njoftimit të tillë nga Ortaku i Vetëm dhe pranimi i dorëheqjes nuk do të jetë i nevojshëm për ta bërë atë efektive.

Article 4.2 Dismissal and Resignation

- a. Dismissal. The Administrator may be dismissed by the Sole Member at any time, with or without cause, whenever the Sole Member determines such dismissal to be in the best interests of the Company.
- b. Resignation. The Administrator may resign by notifying the Sole Member in writing. Unless otherwise specified in this notice, the resignation shall be effective upon receipt of such notice by the Sole Member and acceptance of the resignation shall not be necessary to make it effective.

Neni 4.3 Kompetencat e Administratorit

- a. Përfaqësimi i Shoqërisë. Administratori ka të drejtë të administrojë Shoqërinë, dhe ta përfaqësojë atë në marrëdhëniet me palët e treta.
- b. Menaxhimi i Shoqërisë. Administratori ka të drejtë të menaxhojë punët e përditshme të biznesit të Shoqërisë dhe të ushtrojë çdo kompetencë tjetër në përputhje me këtë Statut dhe dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Article 4.3 Powers of the Administrator

- a. Representation. The Administrator has the right to administer the Company, and represent it in its relationship with third parties.
- b. Management. The Administrator has the right to manage the daily business affairs of the Company, and exercise any other competence in accordance with this Statute and the provisions of the Law on Companies.

KREU V. KAPITALI

Neni 5.1 Kapitali i Regjistruar

- a. Kapitali fillestar. Kapitali i regjistruar i Shoqërisë është 500,000 (pesëqind mijë) lekë dhe përfaqësohet nga 1 (një) kuotë.
- b. Zotërimi i Kuotës. Ortaku i Vetëm është zotëruesi i kuotës së Shoqërisë, që përbën 100% të kapitalit të regjistruar të Shoqërisë.
- c. Ndalimi i Ofrimit për Publikun. Kuotat e Shoqërisë nuk mund të ofrohen si mjete investimi për publikun e gjerë.

CHAPTER V. CAPITAL

Neni 5.1 Registered Capital

- a. Registered Capital. The registered capital of the Company is ALL 500,000 (five hundred thousand Albanian Lekë) and is represented by 1 (one) share .
- b. Owning of the Share. The Sole Member is the owner of the share of the Company, which constitutes 100% of the registered capital of the Company.
- c. No Offering to the Public. Shares of the Company shall not be offered to the public.

d. <u>Vota</u>. Çdo kuotë përfaqëson të drejtën e një vote. e. <u>Shlyerja e kapitalit fillestar</u>. Ortaku i Vetëm do të shlyejë plotësisht kapitalin e regjistruar brenda 1 (një) viti nga data e regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregat të QKB.	d. <u>Voting</u>. Each share represents the right to one vote. e. <u>Payment of Capital</u>. The Sole Member will fully deposit the registered capital within 1 (one) year from the registration date of the Company in the commercial registry of the NBC.
Neni 5.2 Regjistri i Kuotave a. <u>Regjistri i Kuotave</u>. Kuotat dhe zotëruesi i tyre, si dhe të dhëna të tjera që lidhen me kuotat e kapitalit të regjistruar, regjistrohen në një regjister të posaçëm. b. <u>Forma dhe Përmbajtja</u>. Forma dhe modalitetet e tjera të regjistrimit miratohen me vendim të Ortakut të Vetëm.	Article 5.2 Register of Shares a. <u>Register of Shares</u>. The shares and their owner, as well as other data related to the shares of the registered capital, are recorded in a special register. b. <u>Form and Contents</u>. The form and other modalities of the register are approved by decision of the Sole Member.
Neni 5.3 Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit a. <u>Zmadhimi i Kapitalit</u>. Ortaku i Vetëm merr vendim për zmadhimin e kapitalit të regjistruar nëpërmjet kontributit në para dhe/ose kontributit në natyrë. Zmadhimi i kapitalit mund të kryhet nga Ortaku i Vetëm ose nga një person i tretë, i cili me derdhjen e kontributit në kapitalin e Shoqërisë bëhet ortak i saj dhe zotërues i 1 (një) kuote, në proporcion me vlerën e kontributit të derdhur. Për shmangien e çdo dyshimi, futja e një personi të tretë si ortak i shoqërisë nëpërmjet zmadhimit të kapitalit, kryhet me vendim të Ortakut të Vetëm. b. <u>Zvogëlimi i Kapitalit</u>. Zvogëlimi i Kapitalit kryhet me vendim të Ortakut të Vetëm. Në këtë rast, kapitali i Shoqërisë nuk mund të jetë nën minimumin ligjor.	Article 5.3 Increase and Reduction of the Capital a. <u>Increase of Capital</u>. The Sole Member decides on the increase of the registered capital through cash contribution and/or contribution in kind. The increase of capital can be carried out by the Sole Member or a third person, who through his contribution in the Company's capital becomes a member and owner of 1 (one) share, in proportion with the value of his contribution. For the avoidance of any doubt, the introduction of a third person as a member of the Company through capital increase, is carried out by decision of the Sole Member. b. <u>Reduction of Capital</u>. Capital reduction is issued by decision of the Sole Member. In this case, the Company's capital cannot be lower than the legal minimum.
Neni 5.4 Dividendi a. <u>Shpërndarja e Dividendit</u>. Ortaku i Vetëm mund të vendosë të shpërndajë dividendin	Article 5.4 Dividend a. <u>Distribution of Dividend</u>. The Sole Member may decide to distribute the dividend and may

dhe mund të vendosë në lidhje me fitimet që rezultojnë nga bilanci, vetëm nëse pas pagimit të dividendit aktivet e shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e saj dhe Shoqëria ka aktive likuide të mjaftueshme për të shlyer detyrimet që bëhen të kërkueshme brenda 12 (dymbëdhjetë) muajve në vijim.

- b. Deklarimi i Dividendit. Dividendi deklarohet dhe paguhet në raport me vlerën e kapitalit të regjistruar që përfaqëson kuota për të cilën paguhet dividendi.
- c. Rezervat Private. Ortaku i Vetëm mund të vendosë për krijimin e rezervave nga fitimet vjetore.

decide the amount of profits resulting from the balance sheet, only if after the payment of the dividend the Company's assets fully cover its liabilities and the Company has sufficient liquid assets to pay the liabilities that become due within the next 12 (twelve) months.

- b. Declaration of Dividend. The dividend is declared and paid in relation to the value of the registered capital representing the share for which the dividend is paid.
- c. Private Reserves. The Sole Member may decide on the creation of reserves from the annual profits.

KREU VI. BUXHETI

Neni 6.1 Buxheti

- a. Miratimi i Buxhetit. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para çdo Viti Fiskal, Administratori do t'i dorëzojë Ortakut të Vetëm një buxhet të propozuar për Vitin e ardhshëm Fiskal, i cili do të jetë në formën dhe detajet e përcaktuara nga Ortaku i Vetëm. Ky buxhet i propozuar do t'i nënshtrohet shqyrtimit dhe miratimit të Ortakut të Vetëm.
- b. Informacione të tjera financiare. Administratori gjithashtu do t'i paraqesë Ortakut të Vetëm raporte të tjera (financiare ose jo) dhe buxhete që Ortaku i Vetëm mund të kërkojë herë pas here.

Neni 6.2 Librat e Shoqërisë dhe Përputhshmëria

- a. Librat dhe Dokumentet e Shoqërisë. Shoqëria do të mbajë ose do të bëjë që të mbahen librat dhe regjistrimet e duhura sipas Legjislacionit të Zbatueshëm në lidhje me veprimtarinë e Shoqërisë. Librat dhe dokumentet e Shoqërisë do të mbahen në çdo kohë në selinë ligjore të Shoqërisë. Shoqëria do të mbajë në selinë e saj sa vijon:

CHAPTER VI. BUDGET

Article 6.1 Budget

- a. Approval of the Budget. Not later than 30 (thirty) days before each Fiscal Year, the Administrator shall submit to the Sole Member a proposed budget for the following Fiscal Year, which shall be in the form and detail determined by the Sole Member. This proposed budget will be subject to the review and approval of the Sole Member.
- b. Other financial information. The Administrator shall submit to the Sole Member such other reports (financial or otherwise) and budgets as the Sole Member may request from time to time.

Article 6.2 Books of the Company and Compliance

- a. Books and Documents of the Company. The Company shall keep proper books and records in accordance with the Applicable Law relating to the business of the Company. The books and documents of the Company shall at all times be kept at the registered office of the Company. The Company will maintain at its headquarters the following documents:

- i. një kopje të këtij Statuti dhe të gjitha ndryshimet e tij;
 - ii. kopjet e deklarave tatimore dhe raporteve të Shoqërisë, nëse ka, për 3 (tre) vitet më të fundit fiskale;
 - iii. kopjet e çdo pasqyre financiare, nëse ka, të Shoqërisë për 5 (pesë) vitet më të fundit fiskale; dhe
 - iv. dokumente të tjera në lidhje me objektin e veprimtarisë së Shoqërisë që mund të kërkojnë në mënyrë të arsyeshme herë pas here me vendim të Ortakut të Vetëm.
- b. Pajtueshmëria. Shoqëria do të bëjë përpjekjet e saj më të mira për të marrë dhe mbajtur në fuqi dhe të për të zbatuar të gjitha miratimet, pëlqimet ose licencat e nevojshme për zhvillimin dhe përmbushjen e objektit të veprimtarisë.

- i. a copy of this Statute and all amendments thereto;
 - ii. copies of the Company's tax returns and reports, if any, for the most recent 3 (three) fiscal years;
 - iii. copies of any financial statements, if any, of the Company for the most recent 5 (five) fiscal years; and
 - iv. other documents related to the scope of the Company's activity that may be reasonably requested from time to time by a decision of the Sole Member.
- b. Compliance. The Company shall use its best efforts to obtain and maintain in force and to enforce all approvals, consents or licenses necessary for the development and fulfillment of the scope of its activity.

KREU VII. TË NDRYSHME

Neni 7.1 Veçueshmëria

Termat, kushtet dhe dispozitat e këtij Statuti janë plotësisht të ndashme dhe vendimi ose aktgjykim i çdo gjykate të juridiksionit kompetent që e bën të pavlefshëm ose të pazbatueshëm një ose më shumë nga këto kushte, kushte ose dispozita nuk do të bëjë të pavlefshëm ose të pazbatueshëm termat, kushtet ose dispozitat e këtij Statuti dhe një term i tillë i pavlefshëm ose i pazbatueshëm do të zëvendësohet me një term të vlefshëm dhe të zbatueshëm, i cili do të pasqyrojë në masën më të madhe të mundshme synimet origjinale të Ortakut të Vetëm.

Neni 7.2 Legjislacioni i Zbatueshëm

Ky Statut në të gjitha aspektet do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Për aq sa nuk parashikohet në këtë Statut, zbatohen dispozitat e ligjit për Shoqëritë

CHAPTER VII. MISCELLANEOUS

Article 7.1 Severability

The terms, conditions and provisions of this Statute are fully severable and the decision or judgment of any court of competent jurisdiction that renders invalid or unenforceable one or more of these terms, conditions or provisions, shall not render invalid or unenforceable terms, conditions or provisions of this Statute and such invalid or unenforceable term shall be replaced by a valid and enforceable one which shall reflect to the greatest extent possible the original intentions of the Sole Member.

Article 7.2 Applicable Law

This Statute in all aspects will be governed and interpreted in accordance with the laws of the Republic of Albania. To the extent not provided for in this Statute, the provisions of the Law on Companies, the Albanian Civil Code, as well as

Tregtare, të Kodit Civil Shqiptar, si dhe të çdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.


any other specific law in the Republic of Albania shall apply.

Neni 7.3 Prishja dhe Likuidimi

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçëm të Ortakut të Vetëm, mund të shpërndajë në dobi të ortakut të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes.

Article 7.3 Dissolution and Liquidation

In case of liquidation of the Company, the liquidator, in accordance with the Law on Companies and with the special decision of the Sole Member, may distribute all or part of the value of the Company's assets to the benefit of the member and for this purpose, may assess any assets and determine the distribution method.




[PJESA E MBETUR E FAQES ËSHTË LËNË QËLLIMISHT BOSH/ THE REST OF THE PAGE IS LEFT INTENTIONALLY BLANK]

NË EMËR DHE PËR LLOGARI TË ORTAKUT TË VETËM / IN THE NAME AND FOR
THE ACCOUNT OF THE SOLE MEMBER

Thomas Spencer Johnstone III

**(Chief Executive Officer and Chairman of the Board of Directors / Administrator dhe
Kryetar i Bordit të Drejtorëve)**


Thomas Spencer Johnstone III


Signature/Firma

SHTOJCA 1 / ANNEX 1

**SPECIMEN I NËNSHKRIMIT TË ADMINISTRATORIT / SIGNATURE SPECIMEN
OF THE ADMINISTRATOR**

Elkida Bazaj



Signature/Firma